



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
KOMUNËS SË GJAKOVËS PËR VITIN 2019**

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjakovës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit Muhamet Balaj dhe anëtarit Arben Hundozi, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Luljeta Morina.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinion i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	7
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	25
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	32
Shtojca II: Letër Konfirmim	35

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Gjakovës për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore ishin përgatitur sipas kërkesave të kornizës për raportim financiar me përjashtim të keq klasifikimit të shpenzimeve dhe mangësive në shpalosjet e informatave në lidhje me pasuritë.

Komuna e Gjakovës ka vendosur një sistem të menaxhimit financiar dhe kontrollit por që ende nevojiten veprime shtesë për të përmirësuar menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve. Në menaxhimin e të hyrave si dobësi ishte mos respektimi i afateve ligjore gjatë shqyrtimit të ankesave nga tatimpaguesit. Edhe fusha e shpenzimeve është vlerësuar me parregullsi sidomos tek menaxhimi i prokurimeve, menaxhimi i pasurisë, obligimeve si dhe llogarive të arkëtueshme. Kujdes i veçantë duhet ti kushtohet vendimeve gjyqësore dhe pagesave direkte nga Thesari.

Zbatimi i rekomandimeve të auditimit ende mbetet sfidë për Komunën e Gjakovës. Nga 20 rekomandime të dhëna në raportin e vitit të kaluar, shtatë rekomandime ishin zbatuar plotësisht, tetë janë përsëritur, dy janë të mbyllura dhe tri janë në proces (zbatuar pjesërisht). Si rezultat i përsëritjes së rekomandimeve shumë mangësi në sistemet domethënëse të komunës mbetin të pa trajtuara.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinionëve, sipas SNISA-ve.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. ZKA vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Komunës së Gjakovës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Theksimi i çështjes

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se Komuna e Gjakovës ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 849,503€ në kategori ekonomike jo adekuate. Në këtë raport kjo çështje është trajtuar tek nënkapitulli 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit. Opinioni ynë nuk është modifikuar me këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Gjakovës kishte shpenzuar 96% të buxheti final për vitin 2019 që paraqet realizim të kënaqshëm në nivel të përgjithshëm.

Komuna e Gjakovës ka vendosur një sistem të menaxhimit financiar dhe kontrollit por që ende nevojiten veprime shtesë për të përmirësuar menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve. Në menaxhimin e të hyrave si dobësi ishte mos respektimi i afateve ligjore gjatë shqyrtimit të ankesave nga tatimpaguesit. Edhe fusha e shpenzimeve është vlerësuar me parregullsi sidomos tek menaxhimi i prokurimeve, menaxhimin e pasurisë, obligimeve si dhe llogarive të arkëtueshme. Kujdes i veçantë duhet ti kushtohet vendimeve gjyqësore/përmbartimore dhe pagesave direkte nga Thesari.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	Realizimi 2019	Realizimi në % 2019	Realizimi 2018	Realizimi 2017
Burimet e Fondeve:	24,785,173	26,784,154	25,626,846	96%	23,109,387	20,942,026
Grandi i Qeverisë - Buxheti	21,022,765	21,022,765	20,769,401	99%	19,746,629	16,971,867
Të bartura nga viti paraprak ³ -	-	1,833,477	1,533,053	84%	1,073,613	1,080,250
Të hyrat vetjake ⁴	3,495,017	3,495,017	2,978,442	85%	2,009,169	2,026,574
Donacionet e brendshme	-	55,615	2,762	5%	55,583	-
Donacionet e jashtme	-	316,017	295,015	93%	195,647	863,335
Financimi nga Huamarrja	267,391	61,263	48,173	79%	28,746	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,998,981€. Ky ndryshim është rezultat i rritjes së të hyrave të bartura, donacioneve të brendshme dhe të jashtme dhe ndryshimit të financimit nga huamarrja. Në vitin 2019, komuna ka shpenzuar 96% të buxhetit final ose 25,626,846€, me një përmirësim prej 5% krahasuar me vitin 2018.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Realizimi 2019	Realizimi në % 2019	Realizimi 2018	Realizimi 2017
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	24,785,173	26,784,154	25,626,846	96%	23,109,387	20,942,026
Pagat dhe Mëditjet	13,701,106	13,769,244	13,599,827	99%	13,252,491	12,756,145
Mallrat dhe Shërbimet	2,852,316	2,914,906	2,834,453	97%	2,234,275	1,729,401
Shërbimet komunale	586,800	613,646	579,693	94%	549,083	529,428
Subvencionet dhe Transferet	468,000	512,959	482,644	94%	459,573	450,163
Investimet Kapitale	7,176,951	8,973,399	8,130,229	91%	6,613,965	5,476,889

Ekziston një performancë e mirë sa i përket realizimit të buxhetit në nivel të përgjithshëm dhe sipas kategorive ekonomike të Komunës së Gjakovës.

Çështja A1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

UA 2005/08 klasifikimi ekonomik i shpenzimeve - shpenzimet kapitale janë pagesa për përvetësimin e pasurive kapitale fikse, stoqeve, tokës ose pasurive të paprekshme, ndërsa kategoria e mallrave dhe shërbimeve përfshinë blerjet në treg përveç pasurive kapitale fikse, tokës dhe pasurive të paprekshme. Gjithashtu përjashtohen pagesat për të cilat nuk kërkohet kthim, dhe për të cilat organizata buxhetore nuk merr mallra apo shërbime si kthim (subvencione dhe transfere). Transferet kapitale përbëhen nga pagesat e njëanshme të qeverisë, që as nuk krijojnë dhe as nuk shuajnë obligim financiar dhe që bëhen me qëllim të mundësimit që pranuesi të përvetësojë pasuri kapitale.

Siç kemi paraqitur te theksimi i çështjes, komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 849,503€ në kategori ekonomike jo adekuate, si në vijim:

- Nga kategoria e investimeve kapitale, thesari bazuar në vendimet gjyqësore kishte realizuar pagesa në vlerë prej 573,929€⁵, prej tyre 244,441€ ishin për paga përcjellëse për punëtorët me rastin e pensionimit si dhe 329,489€ ishin pagesa për mallra dhe shërbime;
- Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, thesari bazuar në vendimet gjyqësore dhe pagesave direkte kishte realizuar pagesa në vlerë prej 239,990€, prej tyre 218,990€ ishin për paga përcjellëse për punëtorët me rastin e pensionimit si dhe 21,000€ pagesa për investime kapitale; dhe

⁵ Të dhëna janë siguruar nga komuna, po ashtu edhe nga testimi i nëntë rasteve auditori ka arritur tek të njëjtat konkluzione.

- Pagesa në vlerë 35,584€ për kontratën “Ndërtimi-furnizimi me sera”, ishte klasifikuar në kodin ekonomik 22200-Subvencione për përfitues individual, përderisa klasifikimi i saktë duhet ishte në kodin ekonomik 33200-Transfere kapitale për entitete jo publike.

Mangësitë e identifikuar kanë ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin e planifikimit dhe ekzekutimit të drejtë të shpenzimit.

Ndikimi

Klasifikimet nëpër kategori jo adekuat për pagesat përmes vendimeve gjyqësore dhe pagesave direkte nga thesari, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve respektivisht implementimin e projekteve, po ashtu krijojnë kosto shtesë në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe interesit. Klasifikimet jo të sakta japin pamje jo të drejtë për përdoruesit e informacioneve të pasqyrave financiare.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë strikte sipas kategorive ekonomike adekuate. Veçanërisht një planifikim i drejtë i buxhetit dhe shpenzimeve për pagat përcjellëse për punëtorët.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Gjakovës në vitin 2019 ishin në vlerë 3,328,410€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksa për regjistrimin e automjeteve, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Ne kemi testuar 37 mostra substanciale dhe 33 mostra për pajtueshmëri.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e Pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat vetjake	3,495,017	3,495,017	3,328,410	95%	3,121,665	2,684,461
Totali	3,495,017	3,495,017	3,328,410	95%	3,121,665	2,684,461

Përveç të hyrave të prezantuar në tabelë, Komuna ka realizuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror në vlerë prej 589,040€ (të hyrat nga gjobat në trafik 555,010€ dhe të hyrat me vendimet e gjykatave 34,030€).

Çështja A2 - Vonesa në shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve

Gjetja Bazuar në nenin 31 pika 6 të Ligjit nr.06L/055 për Tatimin në pronën e paluajtshme - Komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna mund të zgjasë, deri në tridhjetë ditë kalendarike, afatin për shqyrtimin e ankesës së dorëzuar, me një vendim të arsyetuar.

Nga gjithsej 888 ankesa të shqyrtuara nga komuna, në 57 raste ku tatimpaguesit kanë bërë ankesë lidhur me pasaktësinë e faturës së tatimit në pronë shqyrtimi i tyre është bërë me vonesë, duke tejkalluar afatin ligjor për shqyrtim nga katër deri në shtatë muaj.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i numrit të lartë të ankesave nga ana e tatimpaguesve krahas viteve paraprake dhe vonesave në nxjerrjen e udhëzimeve të brendshme që rregullojnë përgjegjësitë e strukturës organizative të drejtorisë së tatimit në pronë.

Ndikimi Shqyrtimi i ankesave me vonesë nga autoritetet komunale dëmton marrëdhënien ndërmjet komunës dhe tatimpaguesve dhe paraqet shkelje ligjore.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet sigurojë se shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve bëhet brenda afateve ligjore. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollin që të siguroj se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për taksapaguesin.

Çështja A3 - Dobësi në menaxhimin e kontratave të dhënies me qira të pronave të paluajtshme (parcelave dhe lokaleve afariste)

Gjetja Sipas ligjit 06/L-092 për shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, prona komunale duhet të shfrytëzohet në mënyrë efektive me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e vlerës së pronës komunale dhe përmbushjes së interesit të përgjithshëm publik. Sipas Kontratave palët që kanë shfrytëzuar pronat e paluajtshme të komunës janë të obliguara të paguajnë shumat sipas sipërfaqes dhe vlerës për metër katrorë të specifikuar në kontrata në baza mujore.

- Komuna e Gjakovës ka dhënë në shfrytëzim të përkohshëm subjekteve të ndryshme afariste 26 prona të paluajtshme (parcela). Kontratat e të cilave janë lidhur në muaj të ndryshëm të vitit 2009, me një afat 10 vjeçar e të cilat kanë skaduar gjatë vitit 2019. Sipas kartelave individuale gjatë vitit 2019 ishin inkasuar vetëm 7,540€ përderisa kanë mbetur të pa inkasuara edhe 342,480€. Aktualisht të gjitha pronat (parcelat) janë në shfrytëzim nga ana subjekteve afariste pa kontratë valide.

- Pesë prona (parcela) të tjera, komuna i ka dhënë në shfrytëzim një kompanie publike me kontrata njëvjeçare, të cilat kanë përfunduar në mesin e vitit 2015. Komuna nuk ka vazhduar kontratat, ndërsa pronat kanë vazhduar të shfrytëzohen nga kompania publike bazuar në çmimet e kontratave të vjetra. Mjetet e pa inkasuara deri në vitin 2019 janë 31,104€ prej të cilave 10,368€ komuna i ka evidentuar si llogari të arkëtueshme në regjistrat e saj deri me 31.12.2016. Pas vitit 2016 komuna nuk ka faturuar apo inkasuar të hyra nga qiraja për këto prona.
- Komuna e Gjakovës për 53 prona të paluajtshme (lokale afariste) të cilat janë duke u shfrytëzuar nga subjekte të ndryshme afariste nuk kishte kontrata valide. Me vendim të kuvendit komunal janë falur borxhet e të gjitha subjekteve afariste që kanë pasur në shfrytëzim lokalet afariste pa kontratë nga viti 1999 deri në tetor të vitit 2016, me përjashtim të shumës 9,123€ të cilat janë ende të pa inkasuara. Ndërsa pas kësaj periudhe komuna nuk ka faturuar apo inkasuar të hyra nga qiraja për këto prona, të cilat janë duke u shfrytëzuar nga ana subjekteve afariste pa kontrata.

Komuna ka filluar të ndërmarr veprime duke formuar komisione për verifikimin në terren të pronave komunale në fund të vitit 2019, të cilat i ka regjistruar në regjistrat e saj të pasurisë, ndërsa nuk janë ndërmarrë veprime ligjore lidhur me inkasimin e mjeteve.

Deri te kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mungesës së kontrollit për të menaxhuar me pronën komunale, menaxhimit të dobët të kontratave, mos vlerësimit të pronave të dhëna në shfrytëzim dhe mos përfshirja e masave/ndëshkimeve në kontratat bazë në rast vonese apo dështimit për arkëtimin e mjeteve financiare nga qiramarrësit.

Ndikimi

Komuna rrezikon të dëmtojë buxhetin e saj për shumat e vonuara dhe shumat e pa inkasuara për pjesën e shfrytëzimit të pronave të saj nga subjektet private dhe kompania publike, pas skadimit të kontratave dhe mos lidhjes së kontratave të reja. Gjithashtu, shumat e pa inkasuara dëmtojnë edhe rrjedhën e parasë të komunës dhe rrjedhimisht ndikojnë në zvogëlimin e mundësisë së përdorimit të saj në përmbushjen e objektivave ndaj qytetarëve.

Rekomandimi A3 Kryetari i komunës duhet të dizajnoj sistem të avancuar të kontrollit lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale duke i vlerësuar të gjitha kontratat, duke ndërmarr masa në arkëtimin e të hyrave të pa inkasuara. Në dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, Kryetari duhet shfrytëzuar procedurat sipas kërkesave të ligjit 06/L-092 për shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 13,769,244€, i cili ishte shpenzuar 99%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 2,238 punonjës ndërsa në fund të vitit numri i tyre me orar të plotë ishte 2,016 ndërsa me orar të shkurtuar ishin 221 punonjës. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 141 të rinj. Kemi testuar 44 mostra për teste substanciale në vlerë 21,795€, si dhe 21 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A4 - Mungesë e dokumentimit për punën jashtë orarit

Gjetja Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 38 dhe Rregullorja nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë, neni 11.2.3.4 përcakton se; “nëpunësit civil kanë të drejtë të kompensohen ose të marrin kohë të lirë për punën jashtë orarit, nëse mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë paraprakisht ka autorizuar dhe vërtetuar punën jashtë orarit. Kompensimi për punë jashtë orarit me pagesë dhe/apo/ me kohë të lirë bëhet brenda 60 ditësh. Kërkesa për kompensim për punë jashtë orarit dërgohet për aprovim tek udhëheqësi më i lartë administrativ brenda pesë ditëve të punës, pas datës në të cilën janë plotësuar orët e punës jashtë orarit. Ndërsa sipas Ligjit të punës nr. 03/L-212 respektivisht neni 23.7- punëdhënësi është i obliguar të mbajë të dhëna të sakta për punët jashtë orarit dhe t’i prezantojë ato sipas kërkesës së Inspektoratit të Punës”. Komuna përdor sistem elektronik të evidentimit të vijueshmërisë në punë (i cili është aktiv 24h dhe gjatë vikendeve), dhe të gjithë punonjësit janë të pajisur me kartel të vijueshmërisë.

Kryetari i Komunës gjatë vitit 2019 kishte marrë 21 vendime për pagesë të punës jashtë orarit të rregullt, për 10 zyrtar në pozita të ndryshme. Në shtatë raste (për katër zyrtar) të audituara nuk është dokumentuar vijueshmëria për orët shtesë të paguara bazuar në evidencat e siguruara nga sistemi elektronik, evidentimi i hyrje/daljes së zyrtareve komunal. Njëri nga katër zyrtaret nuk e ka përdorur sistemin elektronik fare edhe për orarin e rregullt të punës, ndërsa një tjetër zyrtar kishte probleme në kartelën e tij, përderisa në dy rastet e mbetura nga gjithsej 160 orë të paguara për secilin, është punuar (sipas të dhënave të evidentuar në sistem) vetëm 15 orë dhe 8 orë.

Si rezultat i mosfunksionimit të sistemit të kontrollit në procesin e pagesave jashtë orarit të rregullt të punës dhe mos harmonizimi me sistemin elektronik të vijueshmërisë në punë ka ardhur deri te mbi pagesa e këtyre zyrtarëve.

Ndikimi Kontrolllet e mangëta në monitorimin e sistemit të vijueshmërisë dhe mungesa e dëshmive për pagesën e punës jashtë orarit apo fundjavës dëmton buxhetin e destinuar për paga.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se kontrolli i vijueshmërisë në punë është funksional dhe secila njësi përkatëse përcjell vijueshmërinë në punë të stafit dhe puna jashtë orarit të mbulohet me dëshmi që arsyetohet pagesën.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shërbimet komunale në vitin 2019 ishte 3,528,552€, prej tyre ishin shpenzuar 3,414,146€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me: shpenzime kontraktuese, mirëmbajtja e auto rrugëve dhe ndërtesave, naftë për ngrohje qendrore, furnizim për zyrë dhe pajisje tjera etj. Kemi testuar 37 mostra për teste substanciale në vlerë 393,152€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B1 – Mangësi në angazhimet me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Gjetja Neni 12 pika 4 e Ligjit për Shërbimin Civil Nr. 03/L-149 përcakton që - emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Angazhimet e tilla lejohen të bëhen vetëm për punë specifike dhe në kushte të veçanta e të paparashikuara.

Gjatë vitit komuna kishte angazhuar 74 punonjës përmes MSHV-ve, prej tyre 22 ishin angazhuar për mirëmbajtjen dhe sigurimin e objekteve dhe 52 për punë të ndryshme. Komuna nuk ka zhvilluar ndonjë procedurë formale (të thjeshtëzuar) të rekrutimit edhe pse kishte 40 pozita të përhershme të lira për rekrutim. Këto marrëveshje janë lidhur për shkak të vonësive në procedurat e tenderimit për mirëmbajtjen e objekteve në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Qendrën për Punë Sociale dhe nevojës së komunës për shërbime të ndryshme.

Pamundësia për të rekrutuar pozitat e përhershme të punës ka ndodhur si rezultat i kujdesit jo të duhur dhe pezullimit të ligjit për zyrtar publik nga ana e Gjykatës Kushtetuese në shtator 2019, komuna nuk ka mundur të procedoj me konkurse të rregullta për pozita të përhershme nga shtatori i vitit 2019.

Ndikimi Angazhimi i stafit për shërbime të veçanta pa procedura të thjeshtëzuara rrezikon punësimin e personave jo kompetent në mungesë të konkurrueshmërisë.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të ndërmerri masa në rekrutimin e pozitave të përhershme dhe tenderimin me kohë për shërbimet e mirëmbajtjes në QKMF dhe QPS. Angazhimet me MSHV të aplikohen vetëm për punë specifike dhe kushte të paparashikuara, gjithmonë duke i zbatuar kërkesat ligjore.

Çështja B2 - Hyrja në obligime kontraktuale pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve financiare

Gjetja

Neni 36.1 i LMFPF dhe neni 15.5 i Rregullës financiare për shpenzimin e parave publike Nr.01/2013/MF përcaktojnë që: “Para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, Organizata Buxhetore i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në SIMFK. Asnjë kontratë nuk duhet të nënshkruhet pa zotim të gjeneruar nga SIMFK për vitin aktual fiskal. Zotimi i gjeneruar nga SIMFK është pjesë përbërëse e kontratës”.

Kontrata “Furnizim me fidane të drunjëve dekorativ, luleve dhe pemëve frutore”, e dt. 21.05.2019, në vlerë 82,230€, me afat dy vjeçar të zbatimit, ishte nënshkruar me vetëm 1,000€ zotim të mjeteve financiare.

Mangësitë e identifikuar kanë ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin e planifikimit buxhetor. Ndërsa si rezultat i mungesës së mjeteve financiare, për faturën e dt. 04.10.2019, në vlerë 11,830€, pagesa ishte realizuar nga një projekt tjetër si pagesë direkte nga Thesari, bazuar në nenin 39.2 i LMFPF.

Ndikimi

Hyrja në obligime kontraktuale pa u siguruar mjetet e duhura financiare rrezikon implementimin e drejtë të kontratës si dhe ndikon në procesin e zbatimit të drejtë të projekteve tjera të planifikuara si rezultat i procedimit për pagesë të faturave përmes vendimeve gjyqësore/direkte nga Thesari.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që hyrja në obligime kontraktuale të mos bëhet pa u siguruar mjetet e nevojshme financiare për zbatimin e drejtë të kontratës.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere në 2019 ishte 512,959€, prej tyre ishin shpenzuar 482,644€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me subvencione për përfitues individual, entitete publike dhe jopublike. Kemi testuar pesë mostra për teste substanciale në vlerë 77,834€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë. Të gjeturat lidhur me këtë kategori janë të paraqitura tek çështjet A1 dhe B6.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në 2019 ishte 8,973,399€, prej tyre ishin shpenzuar 8,130,229€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale dhe auto rrugëve, mirëmbajtje investive, ujësjellësi dhe kanalizimi, pajisje tjera etj. Kemi testuar 27 mostra për teste substanciale në vlerë 1,194,405€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B3 - Mangësi në planifikimin dhe menaxhimin e projekteve kapitale

Gjetja Me ligjin vjetor të buxhetit përcaktohen ndarjet buxhetore për financimin e investimeve kapitale, gjithashtu në kontratë përcaktohen kriteret dhe afatet kohore për realizimin dhe përfundimin e projekteve kapitale.

- Kontrata “Ndërtimi-Asfaltimi i rrugës në fshatin Bec dhe në rrugët lokale për lagjet Bajrushaj, Aliaj dhe Shabanaj”, e vitit 2013 në vlerë 278,223€, sipas planit dinamik ishte paraparë të kryhet brenda 72 ditëve. Ndërsa punët dhe pagesa për situacionin e VII, -përfundimtar në vlerë 59,900€ janë realizuar në vitin 2019. Pagesa e pjesshme ishte realizuar në vlerë 32,139€, përderisa pjesa e mbetur në vlerë 27,761€ ishte realizuar nga një projekt tjetër si pagesë direkte nga Thesari, Neni 39.2 i LMFPF;
- Kontrata “Ndërtimi-Asfaltimi i rrugës në fshatin Bec-Lagja Halilaj”, e vitit 2015, në vlerë 124,541€, ishte paraparë të realizohet brenda 3 viteve, 2015-2017, ndonëse me planin dinamik ishte paraparë të kryhet brenda 40 ditëve të punës. Ndërsa punët për situacionin VI përfundimtar në vlerë 39,633€, ishin përfunduar në vitin 2018, përderisa faturimi dhe pagesa ishte realizuar në vitin 2019; dhe
- Kontrata “Ndërtimi-Asfaltimi i rrugës në fshatin Gërgoc”, e vitit 2016, në vlerë 120,523€, ishte paraparë të realizohet brenda 3 viteve, 2016-2018, ndonëse me planin dinamik ishte paraparë të kryhet brenda 45 ditëve të punës. Ndërsa punët dhe pagesa për situacionin III, në vlerë 33,224€ ishin realizuar në vitin 2019.

Vonesat kanë ndodhur si rezultat i nënshkrimit të kontratave pa u siguruar mjetet e nevojshme financiare respektivisht mangësive në procesin e planifikimit të drejtë buxhetor të projekteve kapitale.

Ndikimi Vonesat në përfundimin e projekteve kapitale brenda afateve të përcaktuara reflektojnë negativisht në implementimin e projekteve në harmoni me kushtet kontraktuale dhe në arritjen e qëllimit përkatësisht përfitimit në kohë nga qytetarët për projektet infrastrukturore.

Rekomandimi B3 Kryetari të sigurojë se projektet kapitale planifikohen drejtë në aspektin buxhetor dhe kohorë dhe hyrja në obligime kontraktuale të bëhet vetëm pasi të jenë siguruar mjetet e nevojshme financiare për implementimin e projekteve kapitale.

2.1.6 Çështjet e përbashkëta

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet, subvencione dhe transfere si dhe investimet kapitale:

Çështja B4 - Niveli i lart i pagesave direkte dhe shpenzimet shtesë si rezultat i vendimeve gjyqësore/përmbartimore

Gjetja LMFP, Neni 39.2, përcakton kur një person ka lëshuar një faturë ose kërkesë për pagim për një organizatë buxhetore dhe shuma në fjalë nuk është paguar për një periudhë më të gjatë kohore se gjashtëdhjetë (60) ditë, personi në fjalë mundet ta dorëzojë një kopje të faturës ose kërkesës për pagim në Thesar. Pas pranimit të kopjes së faturës ose kërkesës për pagim, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, brenda tridhjetë (30) ditëve të ardhshme, do të bëjë një hetim në organizatën buxhetore për të vërtetuar nëse (i) fatura ose kërkesa për pagim është e vlefshme dhe se mallrat dhe shërbimet janë furnizuar ose punët janë realizuar, dhe (ii) shuma përkatëse nuk është paguar nga organizata buxhetore për një periudhë më të gjatë kohore se gjashtëdhjetë (60) ditë. Nëse rezultati i hetimit del të jetë pozitiv, Thesari do e paguan shumën në fjalë pa pasur nevojë të marrë miratimin paraprak të organizatës përkatëse buxhetore. Në raste të këtilla, Thesari është i autorizuar që ekzekutojë një njoftim për bartjen e shpenzimit pa miratimin paraprak të organizatës përkatëse buxhetor. Gjithashtu Neni 40, për pagimin e vendimeve të prera gjyqësore, paragrafi 3 përcakton se pas pranimit të vendimit të plotfuqishëm ose urdhrin të formës së prerë, ministria është e autorizuar dhe ka përgjegjësinë që menjëherë të marrë çfarëdo masa të nevojshme për pagimin e vendimit ose urdhrin nga ndarjet buxhetore në dispozicion.

Si rezultat i mos pagesës me kohë të obligimeve financiare dhe kërkesave nga të pensionuarit për paga përcjellëse dhe paga për shpërblime jubilarë, përmes procedurave gjyqësore përkatësisht pagesave direkte nga Thesari ishin realizuar

nga buxheti i komunës pagesa në vlerë 1,358,237€⁶, prej tyre 122,942€ ishin kosto shtesë për shpenzimet gjyqësore, përmbarimore dhe të interesit.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mangësive në procesin e planifikimit respektivisht mungesës së mjeteve buxhetore.

Ndikimi Pagesat e realizuar përmes vendimeve gjyqësore dhe pagesave direkte nga Thesari, vështirësojnë realizimin e buxhetit përkatësisht implementimin e projekteve si dhe mund të ndikojnë në keqklasifikimin e shpenzimeve, po ashtu krijojnë kosto shtese në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe interesit.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë planifikimin e drejtë të buxhetit duke forcuar disiplinën financiare që procesi i realizimit të pagesave të bëhet brenda planifikimeve buxhetore dhe afateve kohore të përcaktuara.

Çështja B5 - Zotimi dhe urdhërblerja me vonesë

Gjetja Neni 36.1 i LMFPF dhe neni 17 pika 1.5 Rregulla financiare për shpenzimin e parave publike Nr.01/2013/MF, përcaktojnë se: zotimi i mjeteve duhet të bëhet para hyrjes në obligime kontraktuale gjithashtu urdhërblerja të krijohet dhe përgatitet nga ana e organizatës buxhetore, pas zgjedhjes së ofertuesit me të cilin është nënshkruar kontrata.

Në tri raste në investime kapitale dhe katër raste në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve zotimi i mjeteve dhe procedimi i urdhërblërjeve ishte bërë me vonesë përkatësisht pas datës së faturave⁷. Kjo ka rezultuar si shkak i kontrolleve jo efikase në procesin e menaxhimit dhe ekzekutimit të pagesave.

Ndikimi Zotimi i mjeteve financiare dhe procedimi i urdhërblërjeve me vonesë vështirëson zbatimin e drejtë të kontratave dhe krijon paqartësi rreth

⁶ Auditori këto të dhëna i bazon në raportin e siguruar nga komuna. Në kuadër të kësaj shume përfshihen mjetet e tërhequra me vendime gjyqësore prej 845,440.71€ prej të cilave kanë rrjedhur shpenzimet e gjyqësorit dhe interesit. Keq klasifikimet si rezultat i vendimeve gjyqësore dhe pagesave direkte të thesarit janë trajtuar në kapitullin baza për opinion dhe në çështjen A1. Në kuadër të këtij popullacioni, auditori ka testuar nëntë raste, në vlerë 150,320€ që kanë rezultuar me 4,005€ shpenzime tjera gjyqësore, në pesë raste shpenzimet ishin keqklasifikuar në kategorinë e investimeve kapitale në vlerë 57,865€ dhe në dy raste në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në vlerë 26,886€, konkluzione këto që janë përputhe me dhënat e komunës.

⁷ Te investimet kapitale në këto pagesa: Zgjerimi i linjës së ndriçimit publik në vlerë 39,360€, Ndërtimi i rrugës me kubëza Jakup Qaushi në vlerë 41,804€ dhe Asfaltimi i rrugës në fsh. Bec Lagj. Halilaj në vlerë 39,633€. Te Mallrat dhe Shërbimet në këto pagesa: Mbikëqyrja profesionale e projekteve investive në vlerë 36,327€, Hartimi dhe përpilimi i projekteve ideore në vlerë 30,000€, Mirëmbajtja e ndriçimit publik në vlerë 22,495€ dhe Mirëmbajtja verore e rrugëve në vlerë 23,054€.

urdhëresave për furnizim, shërbime apo fillim të punëve.

Rekomandimi B5 Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet në harmoni me proceduarat e përcaktuara me LMFPD dhe rregullat financiare për shpenzimin e parave publike.

Çështja B6 - Parregullsi lidhur me sigurimin e ekzekutimit

Gjetja Sipas LPP-së dhe Udhëzuesit për prokurimin publik, siguria e ekzekutimit të kontratës kërkohej si parakusht për nënshkrim të kontratës. Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës dhe do të mbetet valide për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës. Ky kriter ishte kërkuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

- Poashtu, sipas kriterëve kontraktuale përkatësisht nenit 10.1 të kushteve të veçanta të kontratës “Ndërtimi-furnizimi me sera” në vlerë 44,890€, ishte përcaktuar që, kontraktuesi obligohet që pas pranimit të punimeve të bëjë depozitimin e sigurisë së punimeve prej 10% të vlerës së kontraktuar për 12 muaj.

OE nuk kishte sjell vërtetimin lidhur me sigurimin e punimeve. Mangësitë e identifikuara kanë ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin e zbatimit të drejtë të kushteve kontraktuale.

- Kontrata “Rregullimi i Parkut të Qytetit” në vlerë 362,388€, e dt.15.04.2019, ishte paraparë të realizohet brenda tri viteve. Siguria e ekzekutimit fillimisht ishte bërë për periudhën tri vjeçare të kontratës ashtu siç ishte kërkuar në dosje të tenderit. Meqenëse ishin siguruar mjetet financiare shtesë nga të hyrat vetjake të bartura, dhe për vitin 2019 ishin paraparë të realizohen punët deri në vlerë 350,000€, kishte ndryshuar edhe siguria e ekzekutimit dhe mbulonte periudhën 1 vjeçare në kundërshtim me kontratën. Mirëpo, edhe pas kësaj date punët për realizimin e projektit akoma nuk kishin përfunduar. Kjo ka ndodhur si rezultat i mangësive të kontrolleve të brendshme në procesin e planifikimit dhe mos veprimit konform kriterëve të përcaktuara në kontratë dhe rregullave të prokurimit publik.

Ndikimi Mangësitë e identifikuara lidhur me kohëzgjatjen e sigurimit të ekzekutimit mund të reflektojnë negativisht në përmbushjen e drejtë të kontratës konform kushteve kontraktuale.

Rekomandimi B6 Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin e planifikimit të projekteve kapitale dhe sigurimit të kohëzgjatjes së sigurisë së ekzekutimit në përputhshmëri me kriteret kontraktuale dhe rregullat e prokurimit publik përfshirë edhe procesin e realizimit të subvencioneve.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jopakitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 65,006,512€, pasurive jopakitale është 1,266,634€ si dhe e stoqeve 138,687€. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 4,128,128€ si dhe 100 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja C1 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja

Neni 6 i rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare nr.03/2013 përcakton që: “Çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Sipas nenit 22 pika 1 - zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtvizore. Sipas nenit 18 pika 3 - Organizatat buxhetore duhet të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare dhe një aktivitet tjetër që i paraprinë inventarizimit është se komuna duhet nxjerr udhëzim të brendshëm sipas nenit 19 pika 5. Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë. Nga auditimit i pasurisë jopakitale janë testuar gjithsej 100 mostra dhe gjetjet janë si në vijim:

- Komuna nuk kishte regjistruar pasurin jopakitale e cila i takon drejtoratit të arsimit në vlerë prej 100,458€⁸, për këtë vlerë është nënvlerësuar edhe pasuria jopakitale. Kjo gjendje është rezultat i mos kompetencës dhe pakujdesisë së zyrtarëve përgjegjës në regjistrimin e saj.
- Nuk ishte bërë llogaritja e shpenzimeve të zhvlerësimit për vitin 2019 për pasurinë nën 1,000€ nga sistemi e-pasuria dhe për shumën e shpenzimeve të zhvlerësimit është mbivlerësuar pasuria. Kjo gjendje është rezultat i mirëmbajtjes së dobët të sistemit e-pasuria.

Komisioni i inventarizimit ka kryer inventarizimin sipas drejtorive por nuk ka dorëzuar raportin përfundimtar të inventarizimit të pasurisë jo financiare derisa ne ishim në auditim në komunë. Kjo ka ndodhur si rezultat i mos kompetencës nga ana e komisionit dhe mungesës së një

⁸ Pasuria jopakitale e paregjistruar janë: projektor, kompjuter dhe inventar të ndryshëm.

udhëzimi të brendshëm.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurisë jokapitale në sistemin e-pasuria rrezikon humbjen apo përvetësimin e pasurisë në mënyrë të paligjshme. Gjithashtu, mos llogaritja e shpenzimeve të zhvlerësimit mbivlerëson pasuritë jokapitale dhe deformon informatat e shpalosuar në PFV. Po ashtu, mos kompletimi i raportit të inventarizimit të pasurisë ndikon në prezantimin jo të drejt të pasurisë si tërësi në pasqyra financiare.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të siguroj trajnime shitesë për personat përgjegjës në regjistrimin e pasurisë, të ndërmer masa në mirëmbajtjen e softuerit e-pasuria në mënyrë që zhvlerësimi të ndodhë me kohë dhe të nxjerr një udhëzues të brendshëm për inventarizimin e pasurisë duke sqaruar mandatin e plotë dhe të saktë të tij sipas rregullores për menaxhimin e pasurisë jofinanciare.

2.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 9,269,365€. Pjesa më e madhe e këtyre llogarive kanë të bëjnë me tatimin në pronë 8,377,120€, nga kjo vlerë sipas evidencës së komunës 3,253,052€ janë të arkëtueshmet e ndërmarrjeve shoqërore të menaxhuara nga AKP, ndërsa taksa në biznes janë 600,274€, dhe qiraja për shfrytëzimin e pronës komunale 291,971€. Ne testuam 35 mostra për teste substanciale në vlerë 1,511,207€, si dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë për të gjitha llojet e të hyrave.

Çështja B7 - Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Bazuar në neni 27 të Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe nenit 16 të Rregullores për Taksa Tarifa, Ngarkesa dhe Shërbimet Komunale, ku përcaktojnë mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara duke përdorur masat e mbledhjes së detyrueshme. Dhe neneve 1,3 dhe 4 të Ligjit nr.06/L092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Në raport me vitin 2018 kemi një rritje se këtyre llogarive për 396,601€, veçanërisht të ndërmarrjet shoqërore. Testimet tona kanë rezultuar, si në vijim:

- Në dy raste tek tatimpaguesit e tatimit në pronë, vërejtëm se saldoja e borxhit të papaguar ndaj komunës ishte 13,803€, komuna u kishte dërguar këtyre personave letër kujtesë me qëllim të vënies në dijeni për detyrimin ndaj tatimit në pronë, por nuk kishte ndërmarrë veprime shtese për mbledhjen e detyrimit tatimor.
- Në tri raste tek shfrytëzuesit e tokës komunale, vërejtëm se kontraktuesit nuk kishin paguar për shfrytëzimin e parcelave, dhe saldoja e borxhit të papaguar ndaj komunës ishte në total 119,993€. Për me tepër nga marsi i vitit 2019 këtyre kontraktuesve u kishin skaduar kontratat dhe deri në

fund të vitit 2019 e kanë shfrytëzuar pronën (token) e komunës pa marrëveshje kontraktuale.

- Në dy raste tek shfrytëzuesit e lokaleve afariste, vërejtëm se kontraktuesit nuk kishin paguar për shfrytëzimin e lokaleve afariste, dhe saldoja e borxhit të papaguar ndaj komunës në total ishte 9,333€.
- Në tre raste tek subjektet të cilat realizojnë veprimtari afariste vërejtëm se saldoja e borxhit të papaguar ndaj komunës ishte 22,880€.

Komuna nuk ka arritur të krijoj mekanizma adekuat për mbledhjen e detyrimeve tatimore/taksave të papaguara.

Ndikimi

Mos arkëtimi i të hyrave të ngarkuara mund të ndikojë në pamundësinë e Komunës për t'i përmbushur planet e shpenzimeve dhe po ashtu mund të rezultojë në vështirësi të mëtuqeshme në arkëtimin dhe vjetërsimin e të hyrave të ngarkuara. Po ashtu, në mungesë të kontratave për dhënien me qira të pronës komunale, rritet rreziku i mos mbledhjes së obligimeve nga qiramarrësit apo shfrytëzuesit e pronës komunale. Mungesa e veprimeve konkrete për inkasimin e llogarive të arkëtueshme rezulton me rritje të këtyre llogarive.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e borxheve, duke përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbauesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të llogarive të arkëtueshme. Po ashtu, të shqyrtoj mundësin që të jap me qira për një periudhë më të shkurtër kohore pronat komunale për shkak të ndryshimeve të mundshme në tarifatatimore dhe se për të gjithë shfrytëzuesit e pronave komunale të ketë kontrata valide.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019 ishte 957,364€. Në kuadër të kësaj vlere 742,077€ i takojnë faturave të pranuar, 159,789€ janë detyrime për situacionet e punimeve të përfunduara dhe 55,498€ janë detyrime lidhur me vendimet për shpronësim. Për këtë kategori, ne kemi testuar 11 mostra për teste substanciale në vlerë 282,490€, si dhe 6 mostra për teste të pajtueshmërisë duke përfshirë edhe detyrime kontraktuale.

Çështja B8 - Vonesë në pagesën e detyrimeve

Gjetja Me nenin 39 të LMFPF, kërkohet që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallrat dhe shërbimet e realizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Në pesë raste të testuara, pagesa e faturave nuk është bërë brenda afatit kohor prej 30 ditëve, tejkalimi i këtij afati për këto raste ishte nga 30 deri në 107 ditë. Përkundër këtyre vonesave në pagesë, në raportin e detyrimeve të papaguara datojnë detyrime që nga viti 2013.

Shkak i mos pagesës me kohë të detyrimeve është planifikim jo i mirë i alokimit/zotimit të mjeteve dhe inicimi i proceduarve të shpenzimeve pa mjete në dispozicion.

Ndikimi Detyrimet e bartura rrisin rrezikun në realizimin e projekteve dhe në arritjen objektive të komunës. Si rezultat i nevojës për t'i paguar (obligimet) zotimet e viteve paraprake, njëherit kjo ndikon edhe në kosto shtese në rast të padive nga furnitorët.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të siguroj një planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të detyrimeve ndaj OE-ve. Gjithashtu Kryetari duhet siguroj që të kryhen të gjitha detyrimet e viteve paraprake.

2.4.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019, ishte 733,644€ dhe krahas vitit të kaluar kemi një zvogëlim prej 866,235€ apo 54%.

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Detyrimet kontraktuale sipas evidencës së komunës janë në vlerë 9,044,268€ prej tyre 7,145,903€ janë bashkëfinancime.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Komuna ka të themeluar njësinë e auditimit të brendshëm (NJAB) e cila operon me një anëtar, gjithashtu ka të themeluar edhe komitetin e auditimit i cili përbëhet nga pesë anëtarë. NJAB ka përgatitur planin vjetor dhe strategjik të auditimit të brendshëm, në vitin 2019 NJAB ka kryer katër auditime sipas planit vjetor të cilat ishin për: menaxhimin e automjeteve, menaxhimin e kontratave, procedurat e prokurimit dhe drejtoria e urbanizmit.

Çështja B9 - Dobësi në fushën e auditimit të brendshëm

Gjetja

Në fushën e auditimit të brendshëm shpalosim dobësitë në vijim:

- UA 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik sipas nenit 6, “Komiteti i Auditimit emërohet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe përbëhet nga tre ose pesë anëtarë. Kryesuesi i Komitetit të Auditimit nuk duhet të jetë në pozitën udhëheqëse, dy të tretat (2/3) e anëtarëve duhet të jenë të jashtëm, dhe pjesa tjetër nga stafi i brendshëm i subjektit të sektorit publik. Në Komunën e Gjakovës, kryesuesi i Komitetit të auditimit mban pozitën e udhëheqësit të sektorit për ekonomi, gjë e cila nuk është e lejuar me këtë udhëzim, si rezultat i kësaj Komiteti i auditimit nuk ishte funksional. Kjo gjendje ka ndodhur si rezultat i kujdesit jo të duhur të menaxhmentit në zëvendësimin e kryesuesit të komitetit të auditimit.
- Në katër raportet të auditimit të brendshëm ishin dhënë 11 rekomandime, prej tyre vetëm katër janë zbatuar plotësisht, pesë janë në proces dhe dy nuk janë zbatuar. Krahas vitit të kaluar ekziston një përmirësim i lehtë i nivelit të zbatueshmërisë së rekomandimeve, por pra mbetet i pamjaftueshëm.
- Rregullorja (QRK) nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik neni 5, pika 1 kërkon që “udhëheqësi i subjektit të sektorit publik themelon Njësinë e pavarur të auditimit të brendshëm sipas këtyre kriterëve: 1.1 Subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë milionë euro të ketë së paku tre auditorë të brendshëm”. NJAB kishte vetëm një auditor dhe nuk ka arritur ti mbulojë të gjitha fushat me rrezik duke filluar me plotësinë e regjistrave të pasurisë, menaxhimin e kontratave të pronave të dhëna në shfrytëzim, llogaritë e arkëtueshme dhe pagueshme. Kjo ka ndodhur për shkak të burimeve të pamjaftueshme në auditimin e brendshëm në komunë.

Ndikimi

Mosfunksionimi i komitetit të auditimit dhe mungesa e stafit të mjaftueshëm në auditimin e brendshëm rrezikojnë ndihmën potenciale në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe arritjen e objektivave të komunës.

Rekomandimi B9

Kryetari duhet të zëvendësojë kryesuesin e komitetit të auditimit sipas kërkesave të udhëzimit administrativë përkatës dhe të funksionalizojë komitetin e auditimit. Gjithashtu plotësimi i auditimit të brendshëm me staf shtesë është i nevojshëm për të mbuluar fushat me rrezik.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 për Komunën e Gjakovës ka rezultuar në 20 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Komuna ka dorëzuar raportin e progresit mbi zbatimin e rekomandimeve me 08.01.2020 sipas kërkesave të dala nga rregullorja e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, shtatë rekomandime janë zbatuar, tri ishin në proces, tetë nuk janë zbatuar dhe dy ishin të mbyllura të pa zbatuara. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit. Kjo kërkon veprime specifike për të konfirmuar regjistrimin e plotë të pasurisë jo financiare dhe shpalosjen e drejtë të tyre në PFV. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë adresuar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronave përfshirë edhe rishikimin e PFV-ve të vitit 2019 nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme.	Janë ndërmarrë veprime të pjesërishme, sepse edhe këtë vit kemi pasuri jokapitale të paregjistruar.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
2	PVF	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një vlerësim sistematik i shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm.	Janë ndërmarrë veprime dhe në vitin 2019 niveli i ekzekutimit është i kënaqshëm.	Rekomandim i zbatuar.
3	Të hyrat dhe shpenzime	Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontroleve në këtë fushë në mënyrë që shpenzimet dhe të hyrat të klasifikohen drejtë në përputhje me kodet përkatëse ekonomike të përcaktuara me planin kontabël të Thesarit/SIMFK.	Derisa tek të hyrat nuk kishim keqklasifikim tek shpenzimet janë identifikuar edhe këtë vit por me shkaqe tjera.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
4	Të Hyrat	Kryetari duhet të sigurojë monitorim përmes menaxherit të financave për të siguruar se në fund të ditës të gjitha paratë e gatshme të arkëtuara nga ofrimi i shërbimeve komunale deponohen në llogarinë bankare.	Janë ndërmarrë veprime në adresimin e rekomandimit. Në këtë vit nuk janë identifikuar raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar.

5	Paga dhe mëditje	Kryetari duhet të sigurojë se proceset e rekrutimit janë duke u zhvilluar në pajtim të plotë me procedurat dhe rregullat e rekrutimit. Komisionet përzgjedhëse të jenë profesionale dhe të dokumentojnë si duhet të gjitha fazat e procesit të rekrutimit.	Janë ndërmarrë veprime në adresimin e rekomandimit. Nuk janë identifikuar raste të reja.	Rekomandim i zbatuar.
6	Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të thjeshtuara të rekrutimit për punët që konsiderohen të realizohen përmes MSHV-ve. Nevojat për pozitat të rregullta të punës të adresohen në MF gjatë planifikimit buxhetor, e jo të aplikohen MSHV. Kjo formë e angazhimit të kontraktuesve të aplikohet vetëm në rastet urgjente, dhe kur kërkesat të jenë të arsyetuara nga njësitë kërkuese. Pagesat për shërbimet e tilla nuk duhet të tejkalojnë vlerën e kontraktuar.	Nuk janë ndërmarr veprime në adresimin e rekomandimit.	Rekomandim i pa zbatuar.
7	Paga dhe mëditje	Kryetari duhet të sigurojë se zyra e personelit i përmbahet kërkesave të vendimit të qeverisë për dëshmitë që të punësuarit duhet të ofrojnë për të përfituar shtesën në pagë për përvojën e punës. Ndalesat në paga dhe kompensimet të kalkulohen saktë dhe të realizohen në pajtim me kërkesat ligjore.	Janë ndërmarrë veprime në adresimin e rekomandimit.	Rekomandim i zbatuar.
8	Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të sigurojë kontrollin shtesë në çertifikimin e pagesave. Vetëm lëndët që jenë të kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm të procesohen për pagesë.	Janë ndërmarrë veprime në adresimin e rekomandimit.	Rekomandim i zbatuar.
9	Subvencione dhe transfere	Kryetari duhet të sigurojë se përfituesit e granteve plotësojnë në tërësi kushtet e marrëveshjeve për financim. Po ashtu, duhet të sigurohen format e përshtatshme të ndalesave në emër të sigurisë apo garancionit të punimeve. Nëse OE nuk i përmbahet kushteve kontraktuale, Komuna të vlerësoj si mundësi ndalesën e sigurisë së ekzekutimit të kontratës ose mos pagesën e situacionit të fundit të punimeve.	Është ndërmarr veprim i pjesërishtëm.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.

10	Investime kapitale	Kryetari duhet të trajtoj me prioritet dhe të analizojë mundësitë buxhetore në implementimin e këtyre kontratave në afatin më optimal të mundshëm. Po ashtu, komisionet e vlerësimit të tenderëve duhet të vlerësojnë drejtë kriteret dhe analizojnë mirë dëshmitë e ofruara nga ofertuesit dhe OE që nuk janë në përshtatshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit të mos shpërblehen me kontratë.	Janë ndërmarrë veprime në adresimin e rekomandimit.	Rekomandim i zbatuar.
11	Investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se projektet kapitale planifikohen drejtë në aspektin buxhetor dhe në afatin kohor të arsyeshëm të implementimit të kontratës. Hyrja në obligime kontraktuale të bëhet vetëm pasi të jenë siguruar mjetet e mjaftueshme buxhetore. Menaxherët e kontratave të ofrojnë informata të mjaftueshme dhe relevante lidhur me procesin e implementimit të projekteve kapitale. Planet e menaxhimit të kontratave të përmbajnë informata të nevojshme lidhur me afatet, pagesat, dhe progresin e kontratave.	Nuk janë ndërmarr veprime në adresimin e rekomandimit.	Rekomandim i pa zbatuar.
12	Investime kapitale	Kryetari duhet të përforcojë mekanizmat e kontrollit në menaxhimin dhe monitorimin e kontratave. Menaxherët e kontratave nuk duhet të pranojnë punët/furnizimet e pa përfunduara.	Janë ndërmarrë veprime në adresimin e rekomandimit.	Rekomandim i zbatuar.
13	Investime Kapitale dhe Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të sigurojë që të mos hyjë në obligime kontraktuale dhe financiare pa sigurim paraprak të mjeteve buxhetore, si dhe të forcojë disiplinën financiare në pagesën e obligimeve me kohë dhe evitimin e shpenzimeve shtesë.	Nuk janë ndërmarr veprime në adresimin e rekomandimit.	Rekomandim i pa zbatuar.
14	Investime Kapitale dhe Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të sigurojë se obligimet kontraktuale dhe financiare të mos krijohen pa u zotuar paraprakisht mjetet e duhura financiare në SIMFK. Urdhër blerjet e përgatitura dhe të nënshkruara duhet ti paraprijnë procesit të furnizimit apo realizimit të punimeve.	Nuk janë ndërmarr veprime në adresimin e rekomandimit.	Rekomandim i pa zbatuar.

15	Pasuria	Kryetari duhet të sigurojë se janë përmbushur kërkesat ligjore për menaxhim dhe regjistrim të pasurisë. Përmes programit e-pasuria të aplikohet kalkulimi i zhvlerësimit për pasuritë jo kapitale. Procesi i inventarizimit të pasurisë të përfundojë para përgatitjes së PVF, me qëllim që ndryshimet e identifikuara përmes inventarizimit të reflektojnë në shpalosjen e drejtë të pasurisë.	Nuk janë ndërmarr veprime në adresimin e rekomandimit.	Rekomandim i pa zbatuar.
16	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të llogarive të arkëtueshme. Gjithashtu, zyra e financave të mbajë një regjistër të konsoliduar dhe të plotë të ngarkesave dhe pagesave mujore përgjatë viteve për shfrytëzuesit e pronave komunale.	Nuk janë ndërmarr veprime në adresimin e rekomandimit.	Rekomandim i pazbatuar.
17	Llogaritë e pagueshme (Obligimet e papaguara)	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet krijohen vetëm pasi të jenë zotuar paraprakisht mjetet financiare në SIMFK. Pagesa e obligimeve të bëhet brenda 30 ditësh nga pranimi i faturës.	Nuk janë ndërmarr veprime në adresimin e rekomandimit.	Rekomandim i pa zbatuar.
18	NJAB	Kryetari duhet të sigurojë se plani vjetor i AB-së të ketë për fokus fushat më me rrezik dhe të përfshijë kryesisht aktivitetet e vitit aktual. Të përgatiten plane veprimi dhe të adresohen me kohë rekomandimet e AB-së. KA të mos ketë në përbërje anëtar të ekipit ekzekutiv të komunës.	Nuk janë ndërmarr veprime në adresimin e rekomandimit.	Rekomandim i pa zbatuar.
19	Raportimi menaxherial	Kryetari duhet të ndërmarrë veprime konkrete në përgatitjen dhe finalizimin e regjistrit të rreziqeve si dhe të delegoj përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut në drejtorit dhe sektorët e administratës dhe të sigurojë raportim të rregullt për zbatimin e kërkesave në këtë fushë. Vet-vlerësimi vjetor i komponentëve të MFK-së të jetë më objektiv dhe të reflektoj gjendjen aktuale të organizatës.		Rekomandim i mbyllur.

20	Raportimi menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë linja adekuate të raportimit dhe llogaridhënies. Pozitat e ZKF-së dhe ZÇ të jenë në përputhje e kërkesat e LMFPP dhe Ligjit të KBFP-së.	Nuk janë ndërmarr veprime në adresimin e rekomandimit. Kjo çështje është dërguar me letermenaxhment.	Rekomandim i pa zbatuar i mbyllur.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të siguroj që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë strikte sipas kategorive ekonomike adekuate. Veçanërisht një planifikim i drejtë i buxhetit dhe shpenzimeve për pagat përcjellëse për punëtorët.		
2	Të hyrat	Kryetari duhet sigurojë se shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve bëhet brenda afateve ligjore. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollat që të siguroj se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për taksapaguesin.		
3	Të hyrat	Kryetari i komunës duhet të dizajnoj sistem të avancuar të kontrollit lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale duke i vlerësuar të gjitha kontratat, duke ndërmarr masa në arkëtimin e kërkesave të pa inkasuara. Në dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, Kryetari duhet shfrytëzuar procedurat sipas kërkesave të ligjit 06/L-092 për shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.		
4	Paga dhe mëditje	Kryetari duhet të siguroje se kontrolli i vijueshmërisë në punë është funksional dhe secila njësi përkatëse përcjell vijueshmërinë në punë të stafit dhe puna jashtë orarit të mbulohet me dëshmi që arsyeton pagesën.		
5	Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të ndërmerr masa në rekrutimin e pozitave të përhershme dhe tenderimin me kohë për shërbimet e mirëmbajtjes në QKMF dhe QPS. Angazhimet me MSHV të aplikohen vetëm për punë specifike dhe kushte të paparashikuara, gjithmonë duke i zbatuar kërkesat ligjore.		
6	Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që hyrja në obligime kontraktuale të mos bëhet pa u siguruar mjetet e nevojshme financiare për zbatimin e drejtë të kontratës.		
7	Subvencione dhe transfere	Kryetari të sigurojë se projektet kapitale planifikohen drejtë në aspektin buxhetor dhe kohorë dhe hyrja në obligime kontraktuale të bëhet vetëm pasi të jenë siguruar mjetet e nevojshme financiare për implementimin e projekteve kapitale.		
8	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë planifikimin e drejtë të buxhetit duke forcuar disiplinën financiare që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet brenda		

		planifikimeve buxhetore dhe afateve kohore të përcaktuara.
9	Çështjet e përbashkëta	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet në harmoni me procedurat e përcaktuara me LMFPP dhe rregullat financiare për shpenzimin e parave publike.
10	Çështjet e përbashkëta	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin e planifikimit të projekteve kapitale dhe sigurimit të kohëzgjatjes së sigurisë së ekzekutimit në përputhshmëri me kriteret kontraktuale dhe rregullat e prokurimit publik përfshirë edhe procesin e ekzekutimit të subvencioneve.
11	Pasuritë jofinanciare	Kryetari duhet të siguroj trajnime shtesë për personat përgjegjës në regjistrimin e pasurisë, të ndërmerr masa në mirëmbajtjen e softuerit e-pasuria në mënyrë që zhvlerësimi të ndodhë me kohë dhe të nxjerr një udhëzues të brendshëm për inventarizimin e pasurisë duke sqaruar mandatin e plotë dhe të saktë të tij sipas rregullores për menaxhimin e pasurisë jofinanciare.
12	Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e borxheve, duke përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të llogarive të arkëtueshme. Po ashtu, të shqyrtoj mundësin që të jap me qira për një periudhë më të shkurtër kohore pronat komunale për shkak të ndryshimeve të mundshme në tarifatatimore dhe se për të gjithë shfrytëzuesit e pronave komunale të ketë kontrata valide.
13	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të siguroj një planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të obligimeve ndaj OE-ve. Gjithashtu Kryetari duhet siguroj që të kryhen të gjitha obligimet e viteve paraprake.
14	Funksioni i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të zëvendësoj kryesuesin e komitetit të auditimit sipas kërkesave të udhëzimit administrativë përkatës dhe të funksionalizoj komitetin e auditimit. Gjithashtu plotësimi i auditimit të brendshëm me staf shtesë është i nevojshëm për të mbuluar fushat me rrezik.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmim



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunes së Gjakovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.


Ardian Gjini
Kryetar i Komunes së Gjakovës
Data: 21.07.2020

